

KONKLuzionet Operacionale te Mbledhjes së Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur

DATA: 30/11//2022

KRYESOHET: Znj. Milva EKONOMI, Ministër Shteti për Standartet e Shërbimeve, Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP)

MBLEDHJA: No.2

ÇËSHTJET E DISKUTUARA:

Çështja Nr.1 *Miratimi i rregullores së brendshme të funksionimit të Komitetit*

Çështja Nr.2 *Përcaktimi i Bashkëkryetarit, përfaqësues i anëtarëve të organizatave shoqërisë civile në Komitet*

Çështja Nr.3 *Prezantimi i metodologjisë për hartimin e draft-raportit të vetëvlerësimit të arritjes së angazhimeve të Planit të Veprimit 2020-2022*

Çështja Nr.4 *Prezantimi i plotësimit të angazhimeve të Planit të Veprimit 2020-2024*

Çështja Nr.5 *Prezantimi i draft-raportit të vetëvlerësimit të arritjes së angazhimeve të Planit të Veprimit 2020-2022 dhe miratimi i tij*

Çështja Nr.6 *Informacion nga AMSHC mbi drejtimet kryesore të shpërndarjes së fondeve dy vitet e fundit*

Çështja Nr.7 *Prezantimi i procedurave metodologjike për hartimin e Planit të Veprimit OGP 2022-2024*

Çështja Nr.8 *Çështje të tjera*

KONKLuzionet

1. Miratohen konkluzionet operacionale të takimit të Komitetit Shumëpalësh për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur/Open Government Partnership/(OGP) e datës 11.11.2022 dhe ngarkohet AKSHI për publikimin e tyre në faqen e dedikuar ogp.gov.al.
2. Miratohet rregullorja e Komitetit Shumëpalësh për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur/Open Government Partnership/(OGP), dhe ngarkohet AKSHI për publikimin në faqen e dedikuar ogp.gov.al.

3. Miratohet propozimi i anëtarëve të shoqërisë civile të Komitetit Shumëpalësh për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur/Open Government Partnership/(OGP) që zgjedhja e bashkë-kryetarit nga shoqëria civile të zhvillohet në Janar 2023, për efekt të zgjedhjeve që kryhen në dhjetor të anëtarëve të shoqërisë civile në zbatim të ligjit Ligjit nr. 119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile”
4. Miratohet Raporti final i Vetvlerësimit/Monitorimit për zbatimin e Planit Kombëtar për Qeverisjen e Hapur/Open Government Partnership 2020-2022 dhe ngarkohet AKSHI për publikimin në faqen e dedikuar ogp.gov.al.
5. Raporti final i Vetvlerësimit/Monitorimit për zbatimin e Planit Kombëtar për Qeverisjen e Hapur/Open Government Partnership 2020-2022 dërgohet zyrtarisht përmes e-mailit në të dy gjuhët (AL, EN) nga MSHSSH në zyrat qendrore të OGP-së.
6. Në kuadër të lancimit dhe inicimit të procesit për hartimin dhe finalizimin e Planit Kombëtar për Qeverisjen e Hapur/Open Government Partnership 2022-2024 u rikujtua anëtarëve të Komitetit Shumëpalësh për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur/Open Government Partnership/(OGP) dërgimi i propozimeve të reja në përputhje me shkresën No.6493.Prot, datë 22.11.2022.
7. Amshe-ja duhet të dërgojë njoftimin dhe kërkesën në kuadër të lancimit dhe inicimit të procesit për hartimin dhe finalizimin e Planit Kombëtar për Qeverisjen e Hapur/Open Government Partnership 2022-2024 tek të gjithë organizatat e shoqërisë civile në përputhje me databazën e të dhënave që operon dhe bashkëpunon me qëllim shtrirjen e procesit të bashkë-bërjes/co-creation në sa më shumë organizata.